

PESË DËSHIRAT[®] FIVE WISHES[®]

DËSHIRA IME PËR:

Personin që dua të marrë vendime për kujdesin ndaj
meje kur unë nuk mundem

Lloji i trajtimit mjekësor që dua ose nuk dua

Sa në rehati dua të jem

Si dua që të më trajtojnë njerëzit

Çfarë dua që të dinë njerëzit e mi të dashur

shkruani emrin
me shkronja shtypi

print your name

datëlindja

birthdate

Pesë dëshirat

Ka shumë gjëra në jetë që nuk i kemi në dorë ne. Broshura “Pesë dëshirat” ju jep mundësinë të kontrolloni diçka mjaft të rëndësishme: se si do të trajtoheni në qoftë se sëmureni rëndë. Është një formular i lehtë për t’u plotësuar që ju lejon të thoni me saktësi çfarë doni të thoni. Pasi të jetë plotësuar dhe nënshkruar siç duhet ai njihet nga ligjet e shumicës së shteteve.

Çfarë është broshura “Pesë dëshirat”?

“Pesë dëshirat” është testamenti i parë i jetës i cili bën fjalë për nevojat tuaja personale, emocionale dhe shpirtërore si dhe dëshirat tuaja mjekësore. Ju lejon që të zgjidhni personin që dëshironi të marrë vendime për kujdesin tuaj shëndetësor në qoftë se nuk jeni në gjendje t’i merrni vetë. “Pesë dëshirat” ju lejon që të thoni me saktësi se si dëshironi të trajtoheni në qoftë

se sëmureni rëndë. Është shkruar me ndihmën e Komisionit të Shoqatës së Avokatëve Amerikanë në lidhje me problemet ligjore të të moshuarve dhe ekspertëve më të mirë të vendit në lidhje me kujdesin në fund të jetës. Është gjithashtu i lehtë në përdorim. E vetmja gjë që duhet të bëni është që të shënoni një kuti, të shënoni me rreth një udhëzim ose të shkruani disa fjali.

Si ju ndihmon ju dhe familjen tuaj broshura “Pesë dëshirat”

- Ju lejon që të flisni me familjen, miqtë dhe mjekun tuaj në lidhje me mënyrën se si doni të trajtoheni në qoftë se sëmureni rëndë.
- Pjesëtarëve tuaj të familjes nuk do t’u duhet që të hamendësojnë se çfarë doni ju. I mbron ata në qoftë se ju sëmureni rëndë sepse atyre nuk do t’u duhet që

të marrin vendime të vështira pa i ditur dëshirat tuaja.

- Ju mund të dini se çfarë do nëna, babai, bashkëshorti apo miku juaj nëpërmjet testamentit të jetës “Pesë dëshirat”. Ju mund të jeni pranë tyre kur të kenë nevojë për ju më shumë se kurrë. Ju do të kuptoni se çfarë duan në të vërtetë.

Si lindi broshura “Pesë dëshirat”

Për 12 vjet me radhë, një burrë i quajtur Jim Towey punoi nga afër me Nënë Terezën, dhe, për një vit të tërë, ai jetoi në një sanatorium nën drejtimin e saj në Uashington, DC. Duke u frymëzuar nga kjo eksperiencë personale, z. Towey u përpoq të gjente një mënyrë nëpërmjet të cilës pacientët dhe familjet e tyre të planifikonin paraprakisht dhe të përballonin

sëmundjen e rëndë. Si rezultat u krijua broshura “Pesë dëshirat” dhe reagimi ndaj saj ka qenë i jashtëzakonshëm. Është paraqitur në CNN dhe në programin e NBC-së “Today Show” dhe në faqet e gazetave “Time” dhe “Money”. Gazetat e kanë quajtur broshurën “Pesë dëshirat” “testamenti i parë i jetës plot zemër”.

Kush duhet ta përdorë broshurën “Pesë dëshirat”

“Pesë dëshirat” është për këdo person të moshës 18 vjeç e sipër, të martuar, beqarë, prindër, fëmijë të rritur dhe miq. Është përdorur tashmë nga mbi tetë milion amerikanë të të gjitha moshave. Për

arsye se funksionon kaq mirë, avokatët, mjekët, spitalet dhe sanatoriumet, komunitetet besimtare, punëdhënësit dhe grupet e pensionistëve po e shpërndajnë këtë dokument.

Broshura “Pesë dëshirat” deklaron

Në qoftë se jetoni në Distriktin e Kolumbisë ose në një nga **40 shtetet** e shënuara më poshtë, ju mund të përdorni broshurën “Pesë dëshirat” dhe të flini me mendje të qetë duke ditur se i plotëson mjaftueshëm kërkesat e shtetit sipas ligjit:

Alaska	Ajdoho	Mizuri	Rod Ajlënd
Arizona	Illinoi	Montana	Kerolaina e Jugut
Arkansa	Ajua	Nebraska	Dakota e Jugut
Kaliforni	Luiziana	Nju Xhërsi	Tenesi
Kolorado	Mein	Nju Meksiko	Vermont
Kënetikët	Merilend	Nju Jork	Virxhinia
Delauerë	Masaçusets	Kerolaina e Veriut	Uashington
Florida	Mishigën	Dakota e Veriut	Virxhinia Perëndimore
Xhorxhia	Minesota	Oklahoma	Uajoming
Havai	Misisipi	Pensilvenia	Uiskonsën

Në qoftë se shteti juaj nuk është njëri prej 40 shteteve të shënuara në këtë listë, broshura “Pesë dëshirat” nuk i plotëson kërkesat teknike sipas statuteve të shtetit tuaj. Kështu disa mjekë në shtetin tuaj mund të mos jenë të gatshëm ta respektojnë broshurën “Pesë dëshirat”. Megjithatë shumë njerëz nga shtetet që nuk janë në këtë listë e plotësojnë broshurën “Pesë dëshirat” së bashku me formularin ligjor të shtetit të tyre. Ata shikojnë se broshura “Pesë dëshirat” i ndihmon të shprehin gjithçka që duan të shprehin dhe është një udhëzues i vlefshëm për pjesëtarët e familjes, miqtë, kujdestarët dhe mjekët. Shumica e mjekëve dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor e dinë se duhet t’i dëgjojnë dëshirat tuaja pavarësisht nga mënyra se si i shprehni ato.

Si mund të bëj kalimin te “Pesë dëshirat”?

Ju mund të keni tashmë një testament të jetës ose një prokurë të qëndrueshme për kujdesin shëndetësor. Në qoftë se në vend të tyre doni të përdorni broshurën “Pesë dëshirat”, e vetmja gjë që duhet të bëni është që të plotësoni dhe nënshkruani një formular të ri “Pesë dëshirat” sipas udhëzimeve të dhëna. Sapo ta nënshkruani, ai anulon çfarëdolloj direktive paraprake që keni pasur më përpara. Për t’u siguruar se po përdorni formularin e duhur, lutemi bëni sa më poshtë vijon:

- Shkatërroni të gjitha kopjet e testamentit tuaj të mëparshëm të jetës ose prokurën e qëndrueshme për kujdesin shëndetësor. Ose mund të shkruani “revoked” (anuluar) me shkronja të mëdha vertikalisht mbi kopjen që keni. Në qoftë se në përgatitjen e formularëve të vjetër ju ndihmoi një avokat, tregojini atij ose asaj për këtë veprim. *DHE*
- Tregojini agjentit tuaj të kujdesit shëndetësor, pjesëtarëve të familjes dhe mjekut se keni plotësuar një formular të ri “Pesë dëshirat”. Sigurohuni që ata të jenë në dijeni të dëshirave tuaja të reja.

DËSHIRA 1 — WISH 1

Personi i cili dua që të marrë vendime për kujdesin tim shëndetësor kur unë të mos jem në gjendje t'i marr vetë ato.

The Person I Want To Make Health Care Decisions For Me When I Can't Make Them For Myself.

Në qoftë se unë nuk jam më në gjendje të marr vendime për kujdesin tim shëndetësor, ky formular jep emrin e personit të cilin unë e zgjedh që t'i marrë këto vendime në emrin tim. Ky person do të jetë agjenti im i kujdesit shëndetësor (ose një term tjetër që mund të përdoret në shtetin tim, si për shembull prokurator, përfaqësues ose zëvendësues). Ky person do të marrë vendime për kujdesin tim shëndetësor në qoftë se ndodhin të dyja gjërat e mëposhtme:

- Mjeku im kujdestar ose që po më trajton arrin në përfundimin se unë nuk jam më në gjendje të marr vendime për kujdesin tim shëndetësor DHE
- Një profesionist tjetër i kujdesit shëndetësor bie dakord se kjo është e vërtetë.

Në qoftë se shteti ka një mënyrë tjetër për të arritur në përfundimin se unë nuk jam më në gjendje të marr vendime për kujdesin tim shëndetësor, atëherë duhet ndjekur mënyra e shtetit.

If I am no longer able to make my own health care decisions, this form names the person I choose to make these choices for me. This person will be my Health Care Agent (or other term that may be used in my state, such as proxy, representative, or surrogate). This person will make my health care choices if both of these things happen:

- My attending or treating doctor finds I am no longer able to make health care choices, AND
- Another health care professional agrees that this is true.

If my state has a different way of finding that I am not able to make health care choices, then my state's way should be followed.

Zgjedhja e personit të duhur si agjenti juaj i kujdesit shëndetësor Picking The Right Person To Be Your Health Care Agent

Zgjidhni dikë që ju njeh mirë, ju do dhe që mund të marrë vendime të vështira. Bashkëshorti apo një pjesëtar i familjes mund të mos jenë alternativa më e mirë sepse ata janë shumë të përfshirë nga ana emocionale. Ndonjëherë ata janë zgjedhja më e mirë. Ju e dini më mirë. Zgjidhni dikë që është në gjendje të luftojë për ju me qëllim që të plotësohen dëshirat tuaja. Gjithashtu zgjidhni dikë që ka mundësi të jetë afër me qëllim që t'ju ndihmojë kur keni nevojë për ndihmën e tij. Pavarësisht nëse zgjidhni bashkëshortin, një pjesëtar të familjes ose një mik si agjentin tuaj të kujdesit shëndetësor, sigurohuni që të keni folur me të për këto dëshira dhe se personi është dakord që t'i respektojë dhe plotësojë këto dëshira. Agjenti juaj i kujdesit shëndetësor duhet të jetë të paktën 18 vjeç e sipër (në Kolorado 21 vjeç e sipër) dhe nuk duhet të jetë:

- Institucion që ju jep kujdes shëndetësor, përfshi këtu pronarin ose drejtuesin e një institucioni shëndetësor, banesor ose të kujdesit komunitar që ju shërben juve.
- Punonjës ose bashkëshort/e i një punonjësi të institucionit që ju jep kujdes shëndetësor.
- Person që shërben si agjent ose prokurator për 10 ose më shumë persona përveç rastit kur ai ose ajo është bashkëshorti/bashkëshortja juaj ose një i afërm i ngushtë i familjes.
- Your health care provider, including the owner or operator of a health or residential or community care facility serving you.
- An employee or spouse of an employee of your health care provider.
- Serving as an agent or proxy for 10 or more people unless he or she is your spouse or close relative.

Personi që zgjedh si agjentin tim të kujdesit shëndetësor është: The Person I Choose As My Health Care Agent Is:

Emri i parë i zgjedhur *First Choice Name*

Telefoni *Phone*

Adresa *Address*

Qyteti/shteti/zip kod *City/State/Zip*

Në qoftë se ky person nuk është në gjendje ose nuk dëshiron të marrë vendime në emrin tim *OSE* është divorcuar apo ndarë me ligj prej meje, *OSE* ky person ka vdekur, atëherë personat e mëposhtëm janë ata që kam zgjedhur si mundësi e dytë:

If this person is not able or willing to make these choices for me, *OR* is divorced or legally separated from me, *OR* this person has died, then these people are my next choices:

Emri i dytë i zgjedhur *Second Choice Name*

Emri i tretë i zgjedhur *Third Choice Name*

Adresa *Address*

Adresa *Address*

Qyteti/shteti/zip kod *City/State/Zip*

Qyteti/shteti/ zip kod *City/State/Zip*

Telefoni *Phone*

Telefoni *Phone*

Në qoftë se ndërroj mendje në lidhje me agjentin e kujdesit shëndetësor, atëherë unë

If I Change My Mind About Having A Health Care Agent, I Will

- Do t'i shkatërroj të gjitha kopjet e kësaj pjese të formularit "Pesë dëshirat". *OSE*
- Do t'i tregoj dikujt, si për shembull mjekut ose familjes time se dua që ta anuloj ose ndryshoj agjentin tim të kujdesit shëndetësor. *OSE*
- Do të shkruaj fjalën "Revoked" (anuluar) me shkronja të mëdha përgjatë emrit të çdo agjenti fuqinë e të cilit dua ta anuloj. Do të nënshkruaj emrin tim në atë faqe.

- Destroy all copies of this part of the Five Wishes form. *OR*
- Tell someone, such as my doctor or family, that I want to cancel or change my Health Care Agent. *OR*
- Write the word "Revoked" in large letters across the name of each agent whose authority I want to cancel. Sign my name on that page.

E kuptoj se agjenti im i kujdesit shëndetësor mund të marrë vendime për kujdesin tim shëndetësor. Dua që agjenti im të jetë në gjendje të bëjë sa më poshtë vijon: (Lutemi i vini kryq çdo gjëje në listën e mëposhtme që ju nuk doni që ta bëjë agjenti juaj.)

I understand that my Health Care Agent can make health care decisions for me. I want my Agent to be able to do the following: (Please cross out anything you don't want your Agent to do that is listed below.)

- | | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Të marrë vendime për mua në lidhje me shërbimet apo kujdesin tim mjekësor, si për shembull analizat, ilaçet ose operacionet. Ky kujdes apo shërbim mund të bëhet për të gjetur se cili është problemi im shëndetësor ose mënyrën e trajtimit të tij. Mund të përfshijë gjithashtu kujdesin për të më mbajtur gjallë. Në qoftë se kujdesi apo trajtimi ka filluar, agjenti im i kujdesit shëndetësor mund të thotë që ai të vazhdojë ose të ndalet. | <ul style="list-style-type: none"> • Make choices for me about my medical care or services, like tests, medicine, or surgery. This care or service could be to find out what my health problem is, or how to treat it. It can also include care to keep me alive. If the treatment or care has already started, my Health Care Agent can keep it going or have it stopped. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Të interpretojë udhëzimet që kam dhënë unë në këtë formular ose që kam dhënë në diskutime të tjera ashtu siç i kupton dëshirat dhe vlerat e mia agjenti im i kujdesit shëndetësor. | <ul style="list-style-type: none"> • Interpret any instructions I have given in this form or given in other discussions, according to my Health Care Agent's understanding of my wishes and values. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Të miratojë shtrimin tim në një institucion për të moshuar, në spital, sanatorium ose azil. Agjenti im i kujdesit shëndetësor mund të punësojë çfarëdolloj punonjësi të kujdesit shëndetësor që mund të nevojitet për të më ndihmuar ose për t'u kujdesur për mua. Agjenti im mundet gjithashtu ta heqë nga puna punonjësën e kujdesit shëndetësor, po qe nevoja. | <ul style="list-style-type: none"> • Consent to admission to an assisted living facility, hospital, hospice, or nursing home for me. My Health Care Agent can hire any kind of health care worker I may need to help me or take care of me. My Agent may also fire a health care worker, if needed. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Të marrë vendim për të kërkuar, pezulluar ose të mos më dhënë trajtime mjekësore duke përfshirë këtu ushqim dhe ujë të dhënë në mënyrë artificiale dhe çfarëdolloj trajtimesh të tjera për të më mbajtur gjallë. | <ul style="list-style-type: none"> • Make the decision to request, take away or not give medical treatments, including artificially-provided food and water, and any other treatments to keep me alive. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Të shikojë dhe aprovojë lëshimin e kartelës time mjekësore dhe dosjeve të mia personale. Në qoftë se kërkohet nënshkrimi im për marrjen e këtyre dosjeve, agjenti im i kujdesit shëndetësor mund të nënshkruajë për mua. | <ul style="list-style-type: none"> • See and approve release of my medical records and personal files. If I need to sign my name to get any of these files, my Health Care Agent can sign it for me. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Të më dërgojë në një shtet tjetër që të marr kujdesin e nevojshëm ose për plotësimin e dëshirave të mia. | <ul style="list-style-type: none"> • Move me to another state to get the care I need or to carry out my wishes. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Të autorizojë ose refuzojë autorizimin për ilaçe apo procedura të nevojshme që ndihmojnë në lehtësimin e dhimbjes. | <ul style="list-style-type: none"> • Authorize or refuse to authorize any medication or procedure needed to help with pain. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Të ndërmarë çfarëdolloj veprimi ligjor të nevojshëm për të plotësuar dëshirat e mia. | <ul style="list-style-type: none"> • Take any legal action needed to carry out my wishes. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Të dhurojë organe ose inde të vlefshme të miat sipas ligjit. | <ul style="list-style-type: none"> • Donate useable organs or tissues of mine as allowed by law. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Të bëjë aplikim për Medicare, Medicaid ose programe të tjera apo përfitime sigurimi shëndetësor për mua. Agjenti im i kujdesit shëndetësor mund t'i shikojë dosjet e mia personale, si për shembull dokumentet bankare për të parë se çfarë nevojitet për plotësimin e këtyre formularëve. | <ul style="list-style-type: none"> • Apply for Medicare, Medicaid, or other programs or insurance benefits for me. My Health Care Agent can see my personal files, like bank records, to find out what is needed to fill out these forms. |
| <ul style="list-style-type: none"> • Më poshtë paraqiten ndryshime, shtesa ose kufizime në lidhje me fuqinë që ka agjenti im i kujdesit shëndetësor. | <ul style="list-style-type: none"> • Listed below are any changes, additions, or limitations on my Health Care Agent's powers. |

DËSHIRA 2 — WISH 2

Dëshira ime për llojin e trajtimit mjekësor që dua apo nuk dua.

My Wish For The Kind Of Medical Treatment I Want Or Don't Want.

Unë mendoj se jeta ime është e shtrenjtë dhe se unë meritoj të trajtohem me dinjitet. Kur të vijë një kohë që unë të jem shumë sëmurë dhe të mos jem në gjendje të flas për veten, dua që dëshirat e mëposhtme dhe çfarëdolloj udhëzimesh të tjera që i kam dhënë agjentit tim të kujdesit shëndetësor të respektohen dhe plotësohen.

I believe that my life is precious and I deserve to be treated with dignity. When the time comes that I am very sick and am not able to speak for myself, I want the following wishes, and any other directions I have given to my Health Care Agent, to be respected and followed.

Çfarë duhet të keni parasysh ju si kujdestari im

- Unë nuk dua që të kem dhimbje. Dua që mjeku im të më japë ilaçe të mjaftueshme për uljen e dhimbjes edhe në qoftë se kjo do të thotë se do të jem i përgjumur ose do të fle më shumë se zakonisht.
- Nuk dua që mjekët apo infermieret e mia të bëjnë apo të mos bëjnë diçka me qëllim shkaktimin e vdekjes time.
- Dua që të më jepet ushqim dhe lëngje nga goja dhe të mbahem pastër dhe ngrohtë.

What You Should Keep In Mind As My Caregiver

- I do not want to be in pain. I want my doctor to give me enough medicine to relieve my pain, even if that means that I will be drowsy or sleep more than I would otherwise.
- I do not want anything done or omitted by my doctors or nurses with the intention of taking my life.
- I want to be offered food and fluids by mouth, and kept clean and warm.

Në rast urgjence

In Case Of An Emergency

Në qoftë se keni urgjencë mjekësore dhe ju vjen personeli mjekësor me ambulancë, ata mund të shikojnë nëse keni një formular ose byzylyk që thotë “**Mos më rigjallëroni**”. Shumë shtete kërkojnë që personi të ketë plotësuar një formular “**Mos më rigjallëroni**” të nënshkruar nga një mjek. Ky formular i bën të ditur personelit mjekësor të ambulancës se ju nuk doni që ata të përdorin trajtim për mbështetjen e jetës kur jeni në vdekje e sipër. Lutemi konsultohuni me mjekun tuaj për të parë nëse keni nevojë të plotësoni një formular “**Mos më rigjallëroni**”.

If you have a medical emergency and ambulance personnel arrive, they may look to see if you have a **Do Not Resuscitate** form or bracelet. Many states require a person to have a **Do Not Resuscitate** form filled out and signed by a doctor. This form lets ambulance personnel know that you don't want them to use life-support treatment when you are dying. Please check with your doctor to see if you need to have a **Do Not Resuscitate** form filled out.

Ç'kuptim ka për mua “trajtimi për mbështetjen e jetës”

Trajtimi për mbështetjen e jetës nënkupton çdo procedurë mjekësore, aparaturë ose ilaç të përdorur për të më mbajtur gjallë. Trajtimi për mbështetjen e jetës përfshin: aparatura mjekësore që futen në trupin tim për të më ndihmuar të marr frymë; ushqim dhe ujë i dhënë me aparaturë mjekësore (tub ushqyes); reanimacion kardiopulmonar (CPR); operacione serioze; transfuzione gjaku; dializë; antibiotikë dhe çfarëdo gjëje tjetër për të më mbajtur gjallë. Në qoftë se dëshiroj ta kufizoj kuptimin e trajtimit për mbështetje të jetës për shkak të bindjeve të mia personale ose fetare, këtë kufizim e shkruaj sa më poshtë vijon. E bëj këtë gjë për ta bërë mjaft të qartë se çfarë dua dhe në çfarë kushtesh.

Ky është lloji i trajtimit mjekësor që unë dua apo nuk dua në katër situatat e poshtëshënuara. Dëshiroj që këto udhëzime t'i dijë agjenti im i kujdesit shëndetësor, familja ime, mjekët e mi dhe personeli tjetër i kujdesit shëndetësor, miqtë e mi dhe gjithë të tjerët.

Pranë vdekjes:

Në qoftë se mjeku im dhe një profesionist tjetër i kujdesit shëndetësor së bashku vendosin se ka gjasa që unë do të vdes brenda një periudhe të shkurtër kohe dhe trajtimi për mbështetjen e jetës thjesht do ta vonojë momentin e vdekjes time (zgjidhni njërin nga të mëposhtmet):

- Dua që të më jepet trajtim për mbështetjen e jetës.**
I want to have life-support treatment.
- Nuk dua që të më jepet trajtim për mbështetjen e jetës. Në qoftë se e kanë filluar atë, dua që ta ndërpresin.**
I do not want life-support treatment. If it has been started, I want it stopped.
- Dua që të më jepet trajtim për mbështetjen e jetës në qoftë se mjeku im mendon se kjo gjë mund të më ndihmojë. Por unë dua që mjeku im ta ndërpresë dhënien e trajtimit për mbështetjen e jetës në qoftë se nuk po e ndihmon gjendjen time shëndetësore apo simptomat e mia.**
I want to have life-support treatment if my doctor believes it could help. But I want my doctor to stop giving me life-support treatment if it is not helping my health condition or symptoms.

What “Life-Support Treatment” Means To Me

Life-support treatment means any medical procedure, device or medication to keep me alive. Life-support treatment includes: medical devices put in me to help me breathe; food and water supplied by medical device (tube feeding); cardiopulmonary resuscitation (CPR); major surgery; blood transfusions; dialysis; antibiotics; and anything else meant to keep me alive. If I wish to limit the meaning of life-support treatment because of my religious or personal beliefs, I write this limitation in the space below. I do this to make very clear what I want and under what conditions.

Here is the kind of medical treatment that I want or don't want in the four situations listed below. I want my Health Care Agent, my family, my doctors and other health care providers, my friends and all others to know these directions.

Close to death:

If my doctor and another health care professional both decide that I am likely to die within a short period of time, and life-support treatment would only delay the moment of my death (Choose *one* of the following):

Në koma dhe nuk parashikohet të dal prej saj ose të përmirësohem:

Në qoftë se mjeku im dhe një profesionist tjetër i kujdesit shëndetësor së bashku vendosin se unë jam në koma nga e cila nuk pritet që të zgjohem ose përmirësohem, kam dëm në tru dhe trajtimi për mbështetjen e jetës vetëm se do ta vonojë momentin e vdekjes (zgjidhni *njërën* nga të më mëposhtmet):

- Dua që të më jepet trajtim për mbështetjen e jetës.**
I want to have life-support treatment.
- Nuk dua që të më jepet trajtim për mbështetjen e jetës. Në qoftë se e kanë filluar atë, dua që ta ndërpresin.**
I do not want life-support treatment. If it has been started, I want it stopped.
- Dua që të më jepet trajtim për mbështetjen e jetës në qoftë se mjeku im mendon se kjo gjë mund të më ndihmojë. Por unë dua që mjeku im ta ndërpresë dhënien e trajtimit për mbështetjen e jetës në qoftë se nuk po e ndihmon gjendjen time shëndetësore apo simptomat e mia.**
I want to have life-support treatment if my doctor believes it could help. But I want my doctor to stop giving me life-support treatment if it is not helping my health condition or symptoms.

Dëmtim serioz dhe i përhershëm në tru dhe nuk parashikohet që të përmirësohem:

Në qoftë se mjeku im dhe një profesionist tjetër i kujdesit shëndetësor së bashku vendosin se unë kam dëmtim serioz dhe të përhershëm në tru (për shembull, unë mund t'i hap sytë por nuk mund të flas apo kuptoj) dhe nuk pritet që të bëhem më mirë dhe trajtimi për mbështetjen e jetës vetëm se do ta vonojë momentin e vdekjes time (zgjidhni *njërën* nga të mëposhtmet):

- Dua që të më jepet trajtim për mbështetjen e jetës.**
I want to have life-support treatment.
- Nuk dua që të më jepet trajtim për mbështetjen e jetës. Në qoftë se e kanë filluar atë, dua që ta ndërpresin.**
I do not want life-support treatment. If it has been started, I want it stopped.
- Dua që të më jepet trajtim për mbështetjen e jetës në qoftë se mjeku im mendon se kjo gjë mund të më ndihmojë. Por unë dua që mjeku im ta ndërpresë dhënien e trajtimit për mbështetjen e jetës në qoftë se nuk po e ndihmon gjendjen time shëndetësore apo simptomat e mia.**
I want to have life-support treatment if my doctor believes it could help. But I want my doctor to stop giving me life-support treatment if it is not helping my health condition or symptoms.

In A Coma And Not Expected To Wake Up Or Recover:

If my doctor and another health care professional both decide that I am in a coma from which I am not expected to wake up or recover, and I have brain damage, and life-support treatment would only delay the moment of my death (Choose *one* of the following):

Permanent And Severe Brain Damage And Not Expected To Recover:

If my doctor and another health care professional both decide that I have permanent and severe brain damage, (for example, I can open my eyes, but I can not speak or understand) and I am not expected to get better, and life-support treatment would only delay the moment of my death (Choose *one* of the following):

Një gjendje tjetër në të cilën nuk dëshiroj që të mbahem gjallë:

Në qoftë se ekziston një gjendje tjetër në të cilën nuk dëshiroj të më jepet trajtim për mbështetjen e jetës, atë e përshkruaj më poshtë. Në këtë gjendje, mendoj se kostoja dhe barra e trajtimit për mbështetjen e jetës janë të mëdha dhe nuk ia vlejné për përfitimet që do të marr. Prandaj, në këtë gjendje, nuk dua të më jepet trajtim për mbështetjen e jetës. (Për shembull, ju mund të shkruani “gjendje në fazën e fundit”. Kjo do të thotë se shëndeti juaj është keqësuar. Ju nuk jeni në gjendje të kujdeseni në asnjë farë mënyre për veten tuaj nga ana mendore apo fizike. Trajtimi për mbështetjen e jetës nuk do t’ju ndihmojë që të përmirësoheni. Lutemi lëreni vendin bosh në qoftë se nuk keni ndonjë gjendje tjetër që doni të përshkruani.)

In Another Condition Under Which I Do Not Wish To Be Kept Alive:

If there is another condition under which I do not wish to have life-support treatment, I describe it below. In this condition, I believe that the costs and burdens of life-support treatment are too much and not worth the benefits to me. Therefore, in this condition, I do not want life-support treatment. (For example, you may write “end-stage condition.” That means that your health has gotten worse. You are not able to take care of yourself in any way, mentally or physically. Life-support treatment will not help you recover. Please leave the space blank if you have no other condition to describe.)

Tri dëshirat që vijojnë kanë të bëjnë me dëshirat e mia personale, shpirtërore dhe emocionale. Ato kanë rëndësi për mua. Dua të trajtohem me dinjitet pranë fundit të jetës sime, prandaj dua që njerëzit të bëjnë gjërat e shkruara në dëshirat 3, 4 dhe 5 aty ku të jetë e mundur. E kuptoj që familja ime, mjekët e mi dhe institucionet e tjera të kujdesit shëndetësor, miqtë e mi dhe të tjerët mund të mos jenë në gjendje t’i bëjnë këto gjëra ose nuk u kërkohet me ligj që t’i bëjnë këto gjëra. Unë nuk pres që dëshirat e mëposhtme t’i ngarkojnë mjekët e mi ose institucionet e tjera të kujdesit shëndetësor me detyra ligjore të reja apo shtesë. Gjithashtu nuk pres që këto dëshira të justifikojnë mjekun tim ose institucionet e tjera të kujdesit shëndetësor për të mos më dhënë kujdesin e duhur sipas ligjit.

The next three wishes deal with my personal, spiritual and emotional wishes. They are important to me. I want to be treated with dignity near the end of my life, so I would like people to do the things written in Wishes 3, 4, and 5 when they can be done. I understand that my family, my doctors and other health care providers, my friends, and others may not be able to do these things or are not required by law to do these things. I do not expect the following wishes to place new or added legal duties on my doctors or other health care providers. I also do not expect these wishes to excuse my doctor or other health care providers from giving me the proper care asked for by law.

DËSHIRA 3 — WISH 3

Dëshira ime në lidhje me sa rehat dua të jem.

My Wish For How Comfortable I Want To Be.

